REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

PKR.nr.272/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Sami Sharaxhiu, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku, në çështje juridiko penale ndaj të akuzuarit P. K. nga fsh.S. i E. K.D, për shkak të veprës penale grabitje nga neni 329. par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PP/I .nr.140/13 të datës 24.02.2014, në shqyrtim gjyqësorë të mbajtur në prezencën e Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit P. K. dhe av. mbrojtës sipas detyrës zyrtare K. S.,me datën 11.04.2017 muar dhe publikisht shpall këtë:

A K T GJ Y K I M

I AKUZUARI P. K., i lindur me dt..... në fsh.S i K.D, ku edhe jeton, i biri i A. dhe i nënës A. e gjinisë B., ka të kryer shkollën e .... ,i gjendjes së .... ekonomike, i njohur sipas nr.pers....., posedon nr. tel. ... – ...– ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Për shkak se :

Me dt.11.05.2013.,rreth orës 22:00 në fsh.Carabreg K.Deçan,me qëllim të përfitimit të pasurisë së luajtshme për vete, të dëmtuarit P. U. i kanë grabit portofolin së bashku me dokumentacion dhe para në vlerë pre 200 franga zvicerane dhe 150 euro ,në atë mënyrë që i dëmtuari me tu kthyer nga Prishtina së bashku me të pandehurit G. Sh. dhe të miturin Sh.H. rrugës kishin pasur defekt në veturë,ashtu që ndalohen në fshatin Strellc dhe takohen me të pandehurit P.,K. dhe A. që të njëjtit t'ia sigurojnë një servisë të veturave ,më pas të njëjtit së bashku kanë shkuar në Hotel

,,E...”,e nga aty i dëmtuari së bashku me P,G. dhe të miturin Sh.H. kanë udhëtuar më pas në drejtim të Deçanit,ashtu që ende pa arritur në fshatin Drenoc, i pandehuri G. dhe i mituri Sh.H. i thojnë të dëmtuarit që ta ndalojnë veturën kinse për nevoja fiziologjike ,kurse i pandehuri P qëndron në veturë e së bashku me të dëmtuarin P., në momentin kur i mituri Sh.H. dhe i pandehuri G. kthehet tek vetura e të dëmtuarit kanë filluar të bërtasin qiti paret qiti paret me ç’rast të pandehurit P. dhe G. të dëmtuarin e kanë mbajte për krah kurse i mituri Sh.H. ia ka grabit kuletën të dëmtuarit ,së bashku me të holla dhe dokumentacionin dhe më pas janë larguar me vrap nga vendi i ngjarjes.

-me çka ka kryer vepër penale grabitje nga neni 329. par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Andaj gjykata konform nenit 2 ,4 ,7,8 ,41 nenit 42 par.1 pika 1.1 dhe 1.3, nenit 43 par 1.pika 1.2, dhe 1.3, nenit 46, nenit 49 par. 1, pika 1.1., nenit 50, 51, 52 si dhe nenit 329 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. të akuzuarin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që ai përcakton dënimin me gjobë në shumë prej **200(dyqind)** euro e të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej **30(tridhjetë)** ditë nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi,e po që se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, atëherë dënimi me gjobë do të revokohet dhe do të shndërrohet në dënim me burg efektiv e ku një ditë burgu do të llogaritet në shumë prej 20 €, si dhe:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej **3 (tre) vitë** e të cilin dënim i akuzuari nuk do ta vuaj nëse në afat prej **3 (tre) viteve** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor, gjykatës të ia paguaj shumën prej 25 € (njëzetë e pesë) euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, i dëmtuari udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

PTHDKR në Pejë, kundër të akuzuarit P K nga fsh. S i E K.D, dhe të miturit Sh. H. ka ngritur aktakuzë gjegjësisht për të miturin,propozim për shqiptimin e e masës –burgim për të mitur , për shkak të veprës penale ,grabitje nga neni 329. par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së , me propozim që të caktohet shqyrtimi gjyqësorë, të administrohen provat dhe, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë, i akuzuari të shpallet fajtorë, të dënohet sipas ligjit ndërsa të miturit të i

shqiptohet masa e propozuar, njëherit të njëjtit të obligohen në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale.

I akuzuari, në këtë gjykatë është lajmëruar pa ftesë dhe ndaj të njëjtit gjykata me dt.28.09.2016. ka lëshuar urdhër-arrest,ndërsa me dt. 29.11.2016. e ka veçuar procedurën penale në këtë çështje juridiko penale,në lëndën penale PKR.nr. 50/14,ndërsa e ka zhvilluar shqyrtimin fillestar për të pandehurin G. Sh. , kurse lënda penale e veçuar ka marrë numër të rri PKR.nr.272/16.

Pasi që i pandehuri është lajmëruar pa ftesë në këtë gjykatë, gjykata me propozim të prokurorisë ka vendosur që ta mbaj shqyrtimin fillestar dhe e ka veçuar procedurën në këtë çështje juridiko penale dhe ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor ndaj të pandehurit P. K, i cili në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë sipas aktakuzës.

Gjykata,pasi që e ka dëgjuar mendimin e prokurorit të shtetit si dhe mbrojtësit të të akuzuarit të cilët i kanë propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ,e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe fare nuk i ka administruar provat.

Prokurori i shtetit lidhur me dënimin deklaroi se meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, dhe ky pranimi është bërë në baza vullnetare ,i propozoi gjykatës që i njëjti të shpallet fajtorë ,të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale.

Mbrojtësi i të pandehurit av.K. S., lidhur me dënimin deklaroi se meqenëse i mbrojturi im e pranoi fajësinë i propozoi gjykatës që këtë rrethanë ta merr si rrethanë lehtësuese dhe të njëjtit ti jep një dënim më të butë.

I akuzuari lidhur me dënimin deklaroi se në tërësi pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij njëherit shton se më vjen keq për rastin e ndodhur kjo do të jetë hera e fundit që do të bie ndesh me ligjin sepse jam penduar për veprimet e mia në të kaluarën.

Gjykata duke u nisur nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale, grabitje, nga neni 329. par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, konform nenit 73 të KPRK-së, për të akuzuarin i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, si rrethanë lehtësuese gjykata morri për bazë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pastaj pendimin e sinqertë të tij për veprën e kryer penale, mosdënueshmërin e tij të gjerë tanishme, ndërsa gjykata rrethana rënduese për të akuzuarin nuk gjeti dhe për këtë arsye të njëjtit ia shqiptoj dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bindur thellësisht që me këtë dënim do të arrihet qëllimi i sanksionit penal dhe i akuzuari do të parandalohet që në të ardhmen të kryej ndonjë vepër tjetër penale.

Gjykata, konform nenit 450 par 1 dhe 2 nën par.2.6 të KPPRK-së të akuzuarin e ka obliguar në paguarjen e shpenzimeve të paushallit gjyqësor.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, konform nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së,i dëmtuari udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Andaj, nga sa u tha më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti për Krime të Rënda dt. 11.04.2017, PKR.nr.272/16

Sekretarja juridike
Fitore Bojku

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari
Sami Sharaxhiu

UDHËZIM JURIDIK
Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.